

Nr. 02-BD/2026
Prishtinë: 14.01.2026

Bordi Drejtues i ODËS SË INXHINIERËVE NË FUSHËN E NDËRTIMIT, me numër fiskal 603383324, në mbështetje të: nenit 17, paragrafi 5, nënparagrafi 5.3 dhe 5.5 të LIGJIT NR. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit; nenit 24, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 dhe 1.5 të STATUTIT TË ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUdhËN E PËRKOHSHME, të miratuar më datë 31.12.2024, me numër protokoll 8648/24; dhe vendimit të KMTO të datës 22.12.2025 me me numër protokoll 9079/25, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 14.01.2026, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Procedohen për miratim në Mbledhjen e Rregullt të Kuvendit të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës draft rregulloret:
 - 1.1. Rregullorja e Punës së Kuvendit të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës dhe
 - 1.2. Rregullorja për Organizimin e Brendshëm të Administratës së Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës
2. Draft-dokumentet sipas pikës 1 të këtij Vendimi publikohen në faqen zyrtare të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës dhe iu dërgohen Anëtarëve të Kuvendit të OIRK-së.

ARSYETIM

Bordi Drejtues i OIRK-së bazuar në dispozitat ligjore dhe statut, ka përgaditur këto dy Draft-rregullore, të cilat nga data 17.11.2025 deri më 05.12.2025 i janë nënshtruar shqyrtimit publik. Pas afatit të paraparë për vërejtje, sygjerime dhe komente, Bordi drejtues ka shqyrtuar komentet dhe sygjerimet dhe ka hartuar Raportin e shqyrtimit të tyre.

Draft-rregulloret janë plotësuar bazuar në Raportin e shqyrtimit publik dhe draftet finale iu janë dërguar KMTHO-së për marrjen e pëlqimit bazuar në dispozitat ligjore.

Pëlqimi për këto dy Draft- rregullore është marrë më 22.12.2025 dhe draftet finale së bashku me pëlqimin e KMTHO-së i dërgohen Anëtarëve të Kuvendit të OIRK-së për miratim në mbledhjen e rregullt të Kuvendit.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit Mbikëqyrës.
- Anëtarëve Themelues të Odës.
- Arkivit të OIRK-së.

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës			
Komora inxhinjera Republike Kosovo			
Chamber of Engineers of the Republic of Kosovo			
Nisma orig.	OIRK	Nr. i Prot.	17/26
Org. Jedinica		Broj Prot.	
Org. Unit		Prot. No.	
Nr. ifaqove	/	Data:	15.01.26
Br. Stranica		Date:	
Nr. Pages			
PRISHTINË / A			No.1

Bordi Drejtues i OIRK-së:

1. **Arsim Rapuca**, Kryetar i OIRK-së _____
2. **Mimoza Shahini**, Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së _____
3. **Kadri Morina**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____



**ODA E INXHINIERËVE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

4. **Afrim Demiri**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____

5. **Nebi Pllana**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____

6. **Bujar Jupaj**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____

7. **Sami Kolgeci**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____